



SBASHK Arsimimi sot

Korrik, 2025

Gazeta elektronike

SBASHK me Kongres të jashtëzakonshëm, propozoi veprime sindikale për realizim të kërkesave të mësimdhënësve



SBASHK mbajti kongresin e 9-të, të jashtëzakonshëm, gjatë muajit korrik ku edhe propozoi veprime sindikale në rast të mospërmbushjes së kërkesave të mësimdhënësve dhe stafit arsimor, nga ana e qeverisë...(faqe 4)

SBASHK nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me klinikën Euromed



SBASHK në kuadër të ofrimit të shëbrimeve më të lehta dhe me kosto më të ulët për anëtarësinë, gjatë muajit korrik ka nënshkruar marrëveshje...(faqe 7)

Punëtorët e arsimit nuk heshtin



Punëtorët e arsimit të Kosovës me vite e dekada punuan duke luftuar për diturinë kundër errësirës... (faqe 2)


Bisedë me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj



SBASHK-u vazhdimisht ka mbajtur takime e konsultime me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të

universiteteve duke bashkëbiseduar vazhdimisht për kërkuesat e anëtarësisë dhe për situatën aktuale...(faqe 3)

Shfletojmë përshtypjet e pushuesve në bregdetin shqiptar



Mirënjohje dhe respekt për përkushtimin e SBASHK-ut...(faqe 5)



Editorial

Punëtorët e arsimit nuk heshtin



Punëtorët e arsimit të Kosovës me vite e dekada punuan duke luftuar për diturinë kundërrrësisë. Ata u dëshmuar gjithmonë se e duan kombin dhe atdheun dhe për ta janë të gatshëm për sakrifica sublime. Ata edhe në vitet e rënda të pushtimit punuan e nuk u ndalën para dhunës e torturave dhe mbrojtën gjuhën e kulturën e kombit tonë.

Punëtorët e arsimit misionin e shenjtë për edukimin e brezave e vazhduan edhe në ditët e para të lirisë. SBASHK-u vazhdoi angazhimin, siç kishte bërë edhe më parë, dhe me mbështetjen e miqve ndërkombëtarë renovoi e ndërtoi dhjetëra shkolla. U angazhua edhe në detyrat e përditshme dhe herë me dialog e herë edhe me protesta e greva tregoi se punëtorët e arsimit nuk heshtin.

Punëtorët e arsimit, përmes sindikatës së tyre, nuk heshtën e nuk do të heshtin as sot e as kurrë. Kaluan nëpër shumë sfida në 4 vitet e shkuara për shkak të qasjes shumë të gabuar të Qeverisë Kurti ndaj dialogut e sindikatave, por pas çdo sfide unifikoheshin e dilnin edhe më të fortë dhe zëri i tyre vazhdon të jetë kumbues dhe i fuqishëm. Punëtorët e arsimit të Kosovës, që nga çerdhet e deri në universitete, nuk po heshtin as sot, por përmes sindikatës së tyre dhe duke mbajtur Kongres të jashtëzakonshëm treguan se kanë shumë kërkesa legjitime dhe ato do t'i realizojnë përmes dialogut. Por, nëse Qeveria nuk do të ketë qasje të duhur, atëherë do të organizohen protesta e veprime të tjera sindikale, ashtu siç do të kërkojë anëtarësia.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Bisedë me kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj



SBASHK-u vazhdimisht ka mbajtur takime e konsultime me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve, duke bashkëbiseduar vazhdimisht për kërkesat e anëtarësisë dhe për situatën aktuale në arsimin e shtetit tonë. Duke u gjendur në një situatë plot sfida, SBASHK-u, pas konsultimeve në takimet e Këshillit Drejtues, vendosi të thërrasë Kongres të jashtëzakonshëm. Lidhur me këtë ngjarje tepër të rëndësishme për arsimin në Kosovë, biseduam me kryetarin e SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj.

Kongresin e jashtëzakonshëm e mbajtëm duke respektuar zërin e anëtarësisë, për të analizuar situatën aktuale, për të bërë disa ndryshime në Statutin e sindikatës sonë dhe për të vendosur se

çfarë do të veprojmë tutje në shërbim të anëtarësisë dhe në përpjekje për realizimin e kërkesave të tyre legjitime, thotë Jasharaj, i cili shton se Kongresi ishte i jashtëzakonshëm, ngase u mbajt në rrethana me plot sfida. Kjo ngjarje tepër e rëndësishme për sindikatën tonë u mbajt nga larg, përmes kyçjes së delegateve e delegatëve në një platformë online, dhe meriton të lavdërohet për punën e përkushtimit në realizimin e suksesshëm të kësaj ngjarjeje në këtë formë: sekretari i përgjithshëm, z. Ymer Ymeri, por edhe nënkryetarja, znj. Vjollca Shala, dhe stafi – Blendi, Nezi, Afërdita, Drita – dhe kryetarët e veprimtarët nga të gjitha nivelet e arsimit. Ky Kongres kishte rrjedhë të mbarë dhe pati edhe përfundim të suksesshëm të punimeve, duke nxjerrë detyra konkrete dhe vendime, e duke aprovuar edhe një Rezolutë për angazhimet sindikale.

Kryetari Jasharaj shprehet në vazhdim se Kongresi analizoi situatën aktuale, duke shprehur shqetësimin e arsyeshëm për shkak të gjithë kësaj vonese në krijimin e institucioneve, dhe për të cilën situatë SBASHK-u mendon se është fajtorë partia që doli e para. Prandaj, edhe apelon publikisht që institucionet të krijohen dhe të nisë dialogu me sindikatat, me qëllim të zgjidhjes së kërkesave legjitime. Kryetari i SBASHK-ut, në vazhdim të bisedës, tregon se Kongresi, pas një debati përmbajtësor, nxori edhe vendime konkrete, duke autorizuar kryetarin, Kryesinë dhe Këshillin Drejtues të SBASHK-ut që të bëjnë gjithë përpjekjet që me dialog të arrihet realizimi. Por, nëse institucionet nuk kanë vullnet për dialog, atëherë nuk përjashtohen edhe veprimet sindikale, deri edhe te greva e përgjithshme.

Në pyetjen se si do të veprohet tutje, kryetari Jasharaj thekson se SBASHK-u do të vazhdojë me angazhimet në shërbim të anëtarësisë dhe do të veprojë gjithmonë unik dhe sipas zërit të anëtarësisë. “Do të vazhdojmë me organizimin e trajnimeve kudo nëpër komunat e Kosovës, dhe duke u bazuar në vullnetin e anëtarësisë, do të vazhdojmë me takime e konsultime me kryetarët dhe veprimtarët sindikalë. Jemi përgatitur për të debatuar e dialoguar me institucionet që do të krijohen, por jemi të përgatitur edhe për veprime sindikale, nëse do të jemi të shtyrë të veprojmë ashtu.”

GJATË MUAJIT

SBASHK, me Kongres të jashtëzakonshëm, propozon veprime sindikale për realizimin e kërkesave të mësimdhënësve



SBASHK mbajti Kongresin e 9-të, të jashtëzakonshëm, gjatë muajit korrik, ku edhe propozoi veprime sindikale në rast të mospërmbushjes së kërkesave të mësimdhënësve dhe stafit arsimor, nga ana e Qeverisë.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, deklaroi se që nga viti 2022, Ministria e Arsimit ka refuzuar çdo formë bashkëbisedimi me sindikatën, duke bllokuar përpjekjet për një dialog konstruktiv. Ai theksoi mungesën e vullnetit institucional për të adresuar kërkesat e ligjshme të mësimdhënësve.

Në kongres u theksua gjithashtu moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për njohjen e përvojës së punës dhe për mosrealizimin e rritjes së koeficientit të pagave.

Pavarësisht dorëzimit të një versioni të ri të Kontratës Kolektive në nëntor 2024, nuk është bërë asnjë përpjekje për miratimin e saj.

Përfaqësuesit sindikalë shprehën shqetësim për përjashtimin e zërave të arsimit nga trupat profesionale vendimmarrës dhe për mungesën e përfshirjes në Komisionin për Licencimin e Mësimdhënësve.

SBASHK-u ka paralajmëruar se, nëse deri më 20 gusht 2025 nuk rifillon dialogu me Ministrinë e Arsimit dhe nuk ndërmerren hapa konkretë për trajtimin e kërkesave të mësimdhënësve, atëherë do të pasojnë veprime sindikale, përfshirë edhe grevën, gjithnjë në përputhje me ligjin dhe statutin e sindikatës.

Kongresi përfundoi me miratimin e një rezolute që kërkon formimin e një Ekipi të Posaçëm për riorganizimin dhe inovacionin sindikal, me synimin që SBASHK-u të forcojë mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit dhe të ndikojë më shumë në politikën arsimore të vendit.



Kërkesat kryesore të SBASHK-ut janë:

1. Fillimi dhe përfundimi i procesit të negociatave, si dhe nënshkrimi i Kontratës së re Kolektive të Arsimit.
2. Zbatimi i plotë dhe i pakushtëzuar i Kontratës Kolektive ekzistuese, deri në nënshkrimin e Kontratës së re Kolektive të Arsimit.
3. Përfshirja e përfaqësuesve të SBASHK-ut në të gjitha proceset vendimmarrëse që prekin të drejtat e punëtorëve të arsimit.

Propozimi për veprimet sindikale lidhur me Kontratën Kolektive në sektorin e arsimit, që do të ndërmerren nga shtatori 2025 e tutje, janë:

Hapi 1: Paralajmërimi Institucional

- Dërgimi i një letre zyrtare Ministrisë së Arsimit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, me kërkesat:
- Fillimi urgjent i negociatave për nënshkrimin e Kontratës së re Kolektive;
- Zbatimi i plotë i Kontratës Kolektive aktuale, deri në nënshkrimin e kontratës së re.
- Afati për përgjigje: 7 ditë pune.

Hapi 2: Protesta

- Organizimi i një proteste me pjesëmarrjen e Kryesisë së SBASHK-ut, kryetarëve të SKAP dhe përfaqësuesve të sindikatave komunale.

Hapi 3: Veprime Simbolike

- Mbajtja e orës së parë mësimore pa mësim, gjatë së cilës do të informohen nxënësit për të drejtat sindikale dhe rëndësinë e Kontratës Kolektive.

Hapi 4: Grevë Paralajmëruese – Një Orë

- Organizimi i një greve një-orëshe në të gjitha

institucionet publike arsimore.

Hapi 5: Grevë Paralajmëruese – Një Ditë

- Organizimi i një greve një-ditore në të gjitha shkollat publike të Kosovës.

Hapi 6: Grevë e Përgjithshme

- Në rast se nuk ka përmbytje të kërkesave të

mësipërme, do të thirret grevë e përgjithshme në të gjithë sektorin e arsimit publik.

Të gjitha veprimet e planifikuara do të ndërmerren në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 03/L-200 për Greva, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-119.

Shfletojmë përshtypjet e pushuesve në bregdetin shqiptar

Mirënjohje dhe respekt për përkushtimin e SBASHK-ut

Shfletojmë përshtypjet e pushuesve në bregdetin shqiptar Mirënjohje dhe respekt për përkushtimin e SBASHK-ut Aktiviteti tradicional i SBASHK-ut për organizimin e pushimeve në bregdetin shqiptar, për një numër të konsiderueshëm të anëtareve dhe anëtarëve të sindikatës sonë, këtë vit u realizua në tri grupe të ndara. Ata janë ndjerë mirë gjatë gjithë ditëve të pushimit dhe çdo gjë ka shkuar sipas planifikimit të bërë me kohë.

Pushueset dhe pushuesit kanë shprehur mirënjohje e falënderime për SBASHK-un, edhe gjatë vizitës së kryetarit të SBASHK-ut. Një numër i madh i pjesëmarrësve i kanë lënë përshtypjet e tyre edhe me shkrim, në fletoret e përshtypjeve.

Në këtë numër të gazetës sonë po shfletojmë ato dhe, të nderuar lexues, po përcjellim pjesë nga këto përshtypje. Nga to, veçojmë disa që janë shprehur përmes vargjeve.

Në këto vargje shprehet krenaria për bukuritë e detit shqiptar dhe mirënjohja e falënderimi për kryetarin, stafin dhe për të gjithë pushueset e pushuesit që kishin qëndrim të kulturuar e plot dinjitet gjatë gjithë ditëve të pushimit, në ambientet e bukura të "Bonita".

Edhe përshtypjet tjera, që do t'i ruajmë në arkivin e SBASHK-ut, shprehin respekt e mirënjohje për Sekretarin e Përgjithshëm në SBASHK, për stafin dhe për veprimtarët e angazhuar për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti.

Jemi të këqijur më të gjithë
afërsit e mburrovjës së pushi-
mit, duke filluar nga transporti
otomodim, ushqimi e me rëndësi
atmosfera e krijuar nga grupi
mësimdhënësve dhe puntorët ndërmjet
do të jetojmë e do të burrem
"Burre"

PËRSHTYPJET E DUA PËR KREJT ORGA-
- NIZIMIN KËTËJ ORGANIZIMI TË SBASHK-ut
JANA POZITIVE,
-DUKE U MËSUR QË NGA NISTA, ME AUTO-
-BUSA, VENDOSJA, USHQIMI, PLAZHI, ORGANI-
-ZIMI I GJITHMËRREHËS, KËI TË GJITHA
INFORMIMI, SI PËRSHARRËS PËR HARC

Me respekt dhe falenderime të
veçanta për kryesinë e SBASHK-ut
dhe gjithë stafit menaxhues për
organizimin dhe menaxhimin e këtij
pushimi veror 2025!

U jemi shumë mirënjohës dhe të
privileguar që jemi bashkëpjesëmarrës në
këtë pushim të paharrueshëm dhe të
mrekullueshëm!

Falënderimet shkojnë edhe për stafin
dhe menaxhmentin e restorant "BONITA"
Pritja, shërbimi dhe akomodimi janë në
nivele të shkëlqyer dhe pa vërejtje.

E nderuara kryesi e SBASHK-ut, ju
urojmë ju dhe gjithë stafit shëndet
të Republikës së Kosovës suksese në
ruajtimin e drejtë dhe të shenjtë të kombit.

"Që prej fillimit, deri me tani,
jemi të jetë të këqijur gjatë
pushimeve nga SBASHK. të munda
shuar, si në plazhe, poashtu
edhe fjetje, ushqimi, janë
fenomenal, dhe janë për të
ludënuar, si stafi i Hotelit
BONITA, poashtu edhe sindika
të SBASHK-ut. Përkushtimi"

EPRETE 20.06.2025
PREJ DITËS PARË 17.06.2025
ME FJETJE ME USHQIM ME PLAZH
ME MIKËPRITJE DHE BASHKUNIM
MBRENDË SINDIKATËS NË PËRGJESË
JAM E KËNAQUR. UROJ TË VAZHDOJË
KJO EHIRE NË DITËT NË VIJIM.
VALENTINA AJZERAJ
ME RESPEKT!

“Që nga fillimi e deri më tani jemi tejët të kënaqur gjatë pushimeve të mundësuar nga SBASHK, si në plazh, po ashtu edhe fjetja, ushqimi janë fenomenal dhe janë për t’u lavdëruar si stafi i hotelit Bonita ashtu edhe SBASHK-u,” — shprehet një pushues.

“Jemi të kënaqur nga të gjitha sferat e mbarëvajtjes së pushimit, duke filluar nga transporti, akomodimi, ushqimi e më e rëndësishmja, atmosfera e krijuar nga grupi i mësimdhënësve dhe punëtorët ndihmës. Do të jetojmë e s’do ta harrojmë kurrë,” — është shprehur pushuesi tjetër.

“Përshtypjet e mia për krejt organizimin e këtij udhëtimit të SBASHK-ut janë pozitive. Duke filluar që nga nisja me autobusa, vendosja në hotel, ushqimi, plazhi, organizimi i gjithëmbarshtëm e mbi të gjitha informimi,” — thuhet në përshtypjet e një pushuesi tjetër.

“Prej ditës së parë, 17.06.2025, me fjetje, me ushqim, me plazh, me mikpritje dhe bashkëpunimi brenda Sindikatës, në përgjithësi jam e kënaqur. Uroj të vazhdojë kjo e mirë në ditët në vijim,” — ka shkruar një mësimdhënëse-pushuese tjetër.

Kurse një pushues nga Prishtina ka thënë kështu: “Kjo vizitë është e mirëseardhur për ne. Që nga Prishtina e deri në hotel, organizimi ka qenë në nivel me çdo detajisht të mirëimenduar. Gjithashtu edhe në hotel, ushqimi, pastërtia në dhoma, shërbimi, komunikimi — shumë perfekt. Respekt për udhëheqësinë e grupit të parë, jeni shembull,” — është shprehur një pushues tjetër.

Redaksia e gazetës “Arsimimi sot” falënderon pushueset e pushuesit që kanë lënë përshtypjet e tyre të shkruara dhe ato do t’i ruajmë me kujdes në arkivin e SBASHK-ut.

“Me respekt dhe falënderime të veçanta për kryesinë e SBASHK-ut dhe gjithë stafit menaxhues për organizimin dhe menaxhimin e këtij pushimi veror 2025!

U jemi shumë mirënjohës dhe të privilegjuar që jemi bashkëpjesëmarrës në këtë pushim të paharrueshëm dhe të mrekullueshëm!

Falënderimet shkojnë edhe për stafin dhe menaxhmentin e restorant “Bonita”. Pritja, shërbimi dhe akomodimi janë në nivelin e shkëlqyer dhe pa vërejtje.

go vizite është e mirëseardhur për
me që nga Prishtina deri në hotel
organizimi ka qenë në nivel me
çdo detaj ishte ishte mirë i menduar.
Gjithashtu edhe në hotel gjitha
ushqimet, pastërtia në dhoma
shërbimi komunikimi shumë perfekt
Respekt për udhëheqësinë e gr. 1
jeni shembull nga kryetari SBASHK
me staf.

E dashur kryesi e SBASHK-ut, ju urojmë ju dhe gjithë stafit arsimor të Republikës së Kosovës sukses në rrugëtimin e drejtë dhe të shenjtë të kombit,” — ka shkruar një pushues. Ndërsa një përshtypje të cilën e kemi pranuar vetëm në formë elektronike (por jo të shkruar në letër), do ta postojmë vetëm si shkrim:

“Letër përshtypjeje nga pushimi gjashtëditor në Durrës”

Pushimi gjashtëditor në bregdetin e Durrësit, i organizuar nga SBASHK-u, ishte një përjetim i paharrueshëm që na solli çlodhje, miqësi të reja dhe mirënjohje të thellë për organizatorët dhe mikpritësit tanë. Rruga drejt bregdetit kaloi në atmosferë të këndshme, me shoqëri të mirë dhe pritje të ëmbla për ditët që na prisnin. Në mbërritje, u sistemua në një hotel buzë detit, me kushte të mira dhe staf të sjellshëm. Dhomat ishin të rregullta dhe të pastra, ndërsa ambienti përreth na ftoi menjëherë drejt qetësisë dhe relaksit.

Ushqimi ishte i bollshëm dhe me shije të veçantë – menytë e përzgjedhura përfshinin gatime tradicionale dhe detare, që na kujtuan shijen e vërtetë të mikpritjes durrsake. Në çdo vakt ndiheshim si në shtëpinë tonë, të respektuar dhe të përkujdesur. Një nga përfitimet më të mëdha të këtij organizimi ishte njohja dhe shoqërimi me kolegë nga vise të ndryshme të Kosovës, me të cilët ndamë përvoja, kënduam, biseduam e madje hodhëm edhe ndonjë valle në tingujt e muzikës shqipe. Organizimet e përditshme – si shëtitjet buzë detit, aktivitetet argëtuese në mbrëmje dhe bisedat e hapura mes kolegësh – krijuan një atmosferë të veçantë bashkësie dhe solidariteti.

Në fund, nuk mund të mos shprehim falënderimin tonë të thellë për SBASHK-un, i cili me përkushtim e organizim të shkëlqyer bëri të mundur këtë përvojë kaq të bukur. Po ashtu, një përlujtje e veçantë për mikpritjen e durrsakëve, që na bënë të ndihemi si pjesë e tyre. Këto gjashtë ditë nuk ishin vetëm pushim, por edhe rigjallërim shpirtëror, forcim i lidhjeve kolegjiale dhe dëshmi se bashkimi ynë, si komunitet arsimor, ka vlerë e jetë të gjatë,” — ka shkruar ky pushues.

Flasin ata që u angazhuan për rrjedhën e mbarë të pushimeve në bregdetin shqiptar.

Ndjehem krenar me respektin dhe mirënjohjen e shprehur nga pushuesit.

Tri grupet e pushuesve në bregdetin shqiptar kanë shprehur respekt dhe mirënjohje për organizimin e shkëlqyer të aktivitetit tradicional të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë.

Për këtë, numër të gazetës sonë kemi biseduar me Sekretarin e Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, dhe me anëtarët tjerë të komisionit që u kujdesën për organizimin dhe rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti për pushuesit, që ishin të ndarë në tri grupe.



Ymer Ymeri tregon se ishin kryer me kohë të gjitha përgatitjet për t'u nisur mbarë ky aktivitet. Ai përgëzoi për angazhimet gjithë stafin dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve, të cilët u angazhuan me përkushtim, dhe prandaj ky aktivitet u realizua me plot sukses edhe këtë vit.

“Kemi pasur shumë angazhime, por kemi harruar lodhjen e stresin duke dëgjuar ato që thoshin pushuesit për këtë aktivitet. Falënderoj gjithsecilin veç e veç për punën, angazhimin dhe përgjegjësitë e marra në organizimin, pa asnjë vërejtje, të këtij aktiviteti tashmë tradicional të SBASHK-ut”, është shprehur Ymeri.



Blendor Shatri – Jemi angazhuar bashkë me anëtarët tjerë të komisionit dhe ia kemi dalë që, me sukses, të organizojmë dhe realizojmë pushimet në bregdetin shqiptar.



Nezafete Jakupi – Më vjen mirë që pushuesit kanë kaluar mirë gjatë gjithë ditëve të pushimit. Kemi komunikuar vazhdimisht me ta dhe ndiheshim krenarë kur ata shpreheshin me fjalë falënderimi për angazhimin tonë.



Afërdita Mirena – Me kënaqësi u angazhova që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë dhe bashkërisht kemi arritur që ky aktivitet të përfundojë me sukses të plotë. Me kënaqësi po lexoj përshtypjet e shumë prej pushuesve.

SBASHK nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me klinikën Euromed.



SBASHK, në kuadër të ofrimit të shërbimeve më të lehta dhe me kostot më të ulëta për anëtarësinë, gjatë muajit korrik ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me klinikën Euromed në Fushë-Kosovë.

Edhe pas angazhimeve të shumta në shërbim të anëtarësisë, duke qenë përblyer në shenjë respekti me pushime në bregdetin shqiptar mbi 400 mësimdhënësve gjatë muajit qershor, SBASHK vazhdon të mendojë për kujdesin e mësimdhënësit dhe punonjësit arsimor, i cili po ballafaqohet me shtrenjtimit e mëdha dhe rritjet e çmimeve në çdo fushë të jetës.

Në kuadër të ofrimit të ndihmës së anëtarësisë, SBASHK vazhdon të ndikojë në zbritje për shërbimet e ndryshme, qofshin ato edhe solide për anëtarët e vet në fushata të ndryshme, e sidomos ato shëndetësore, të cilat dhe janë shërbime me prioritet për qytetarin.



Marrëveshja e SBASHK-ut me Euromed është marrëveshja e radhës që për anëtarët e Sindikatës ofron zbritje në shërbime si kontrollat e mjekësisë familjare, dhënien e terapisë si infuzione, ineksione etj. Me këtë marrëveshje, anëtarët e SBASHK-ut përfitojnë zbritje edhe në shërbime intervenimesh kirurgjike, vizita specialistike etj.

Marrëveshja, e cila ka për qëllim ndihmën e anëtarësisë për ofrimin e shërbimeve të nevojshme shëndetësore, u nënshkrua nga Sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, z.

Ymer Ymeri, dhe Drejtori i Euromed-it, z. Leart Jakupi. Sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, z. Ymer Ymeri, falënderoi Drejtorin e Spitalit Euromed, z. Leart Jakupi, duke theksuar:

“Ndjejmë nevojën t’i shprehim mirënjohjen më të sinqertë për konsideratën dhe vlerësimin që keni treguar ndaj punonjësve të arsimit në Kosovë. Ofrimi i zbritjeve për shërbimet shëndetësore që ofron spitali juaj për anëtarët e SBASHK-ut nuk është vetëm një akt solidariteti, por edhe një dëshmi e qartë e respektit që kemi për mësimdhënësit dhe për vetë Kosovën.

Ky gjest fisnik është një shembull frymëzimi dhe model bashkëpunimi që dëshirojmë ta shohim më shpesh në shoqërinë tonë. Ju falënderojmë për këtë mbështetje kaq të çmuar dhe jemi të bindur se ky bashkëpunim do të thellohet edhe më tej në të ardhmen në shërbim të përbashkët të arsimit dhe shëndetit.”

Marrëveshja ofron zbritje deri në 20 përqind për disa shërbime shëndetësore që i ofron kjo klinikë, derisa zbritjet për disa shërbime tjera arrijnë deri në 10 përqind.

Marrëveshja u lidh më datën 10 korrik 2025 dhe vlen për një vit kalendarik.

SBASHK mbajti testet për dy grupet e mësimdhënësve në Prishtinë.



SBASHK gjatë korrikut organizoi edhe testet për dy grupet e mësimdhënësve në Prishtinë, të cilët e kanë përfunduar trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” — një grup në modulën I dhe grupi tjetër në modulën II të trajnimit.

Testi për mësimdhënësit që e kanë përfunduar trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” – moduli II, u administrua nga Nënkryetaria e SBASHK-ut, Vjollca Shala, kurse testi për programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” – moduli I, u administrua nga Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri.



I pranishëm ishte edhe trajneri që e udhëhoqi trajnimin e modulit të dytë, Arben Zymeri, si dhe kryetari i SKAP-it për Prishtinë, Qamil Hajdini.

SBASHK vazhdon me organizimin e trajnimeve në mbarë Kosovën në dy programet e licencuara: “**Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie**” dhe “**Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social.**”